



Mus-e Kosova

PUNA ME RINI NGA KËSHILLI I EVROPËS (COUNCIL OF EUROPE)

FONDACIONI EVROPIAN I RINISË (EUROPEAN YOUTH FOUNDATION)



Ky udhëzues është përgatitur nga OJQ Mus-e Kosova me mbështetje të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në Kosovë. Qëndrimet e reflektuara janë përgjegjësi e OJQ Mus-e Kosova dhe asesi e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.



PUNA ME RINI NGA KËSHILLI I EVROPËS (COUNCIL OF EUROPE)

FONDACIONI EVROPIAN I RINISË (EUROPEAN YOUTH FOUNDATION)

Ky udhëzues është përgatitur nga OJQ Mus-e Kosova për të lehtësuar informacionin për organizatat rinore rreth aplikimit të Erasmus+ në Kosovë. Të gjitha informatat janë grumbulluar, përpunuar dhe thjeshtëzuar duke shfrytëzuar informacionin zyrtar për Erasmus + me qëllim të lehtësimit për aplikime në programet Erasmus+ për organizatat rinore në Kosovë.

PËRMBAJTJA

5	Çfarë është Fondacioni Evropian i Rinisë?
5	2020-21 Prioritetet e sektorit të rinisë të Këshillit të Evropës (Council of Europe)
6	Politika Rinore
6	Cili është qëllimi i politikës rinore të Këshillit të Evropës?
6	Çfarë është politika rinore?
8	Kush vendos për politikat rinore?
8	Politikat Rinore në Kosovë
9	STRATEGJIA PËR RININË 2019-2023
10	Fondacioni Rinor Evropian (European Youth Foundation)
10	Kush mund të aplikoj?
10	Çfarë mbështetet në kuadër të Fondacioni Rinor Evropian (European Youth Foundation)
11	Vendimi për Grante
11	Disa nga temat që mbështeten nga Fondacioni Rinor Evropian (European Youth Foundation)
11	Si të aplikojmë (6 Kriteret)
11	Regjistrimi i organizatës online
12	Afatet për aplikim
12	Materiale të rëndësishme për organizim të EDUKIMIT JO FORMAL

ÇFARË ËSHTË FONDACIONI EVROPIAN I RINISË?

Fondacioni Evropian i Rinisë (European Youth Foundation) është një fond i krijuar në vitin 1972 nga Këshilli i Evropës për të ofruar mbështetje financiare dhe arsimore për aktivitetet rinore evropiane.



2020-21 Prioritetet e sektorit të rinisë të Këshillit të Evropës (Council of Europe)

Prioritetet strategjike për çdo program dyvjeçar të sektorit të rinisë përcaktohen nga Këshilli i Përbashkët për Rininë (Joint Council on Youth) i cili është organi politik qendror i bashkëmenaxhuar i sektorit të të rinjëve.

Tri prioritetet strategjike për 2020-2021 do të janë:

- Promovimi i qasjes së të rinjve në të drejtat dhe mbështetja e tyre në mbrojtjen e edukimit për të drejtat e njeriut dhe demokracinë;
- Lehtësimi i autonomisë dhe pjesëmarrjes së të rinjve përmes promovimit të politikave rinore dhe punës rinore, si dhe mbështetjes për organizatat rinore;
- Angazhimi i të rinjve në ndërtimin e paqes dhe kohezionit social, për të luftuar diskriminimin dhe përjashtimin.

POLITIKA RINORE

Cili është qëllimi i politikës rinore të Këshillit të Evropës?

Politika rinore e Këshillit të Evropës (Council of Europe) nxit vlerat e Organizatës për demokracinë, të drejtat e njeriut, dhe sundimin e ligjit përmes edukimit joformal, politikës rinore dhe praktikës.

Programi i Këshillit të Evropës fokusohet në brezin në zhvillim dhe u mundëson të rinjve të bëhen qytetarë evropianë të angazhuar dhe të përgjegjshëm, të cilët mbrojnë të drejtat e njeriut dhe marrin pjesë plotësisht në jetën demokratike. Temat kryesore që informojnë politikën rinore janë:

- Të drejtat e njeriut dhe demokracia;
- Të jetuarit së bashku në shoqëri të ndryshme;
- Përfshirja sociale e të rinjve.



Çfarë është politika rinore?

Qëllimi i politikës rinore është krijimi i **kushteve për mësim, mundësi dhe përvojë**, të cilat u mundësojnë të rinjve të zhvillojnë **njohuri, aftësi dhe kompetenca**.

Kjo u mundëson të rinjve të jenë aktorë të **demokracisë**, të **integrohen në shoqëri** dhe, në veçanti, të luajnë një **rol aktiv** si në shoqërinë civile, ashtu edhe në tregun e punës.

Masat kryesore të politikave rinore janë promovimi i të mësuarit qytetar dhe qasjes së politikave të integruara.

Politika për të rinjtë është:

“Angazhimi dhe praktika e qeverisë për të siguruar kushte dhe mundësi të mira jetese për popullatën e re të një vendi” (Finn Denstad, Manuali i Politikave Rinore, 2009)¹

Politikat rinore përfshijnë: Standardet, metodologjia (parimet, bashkëpunimi), grupet e synuara / palët e interesuara, qëllimi (fushat e ndërhyrjes), buxhetet etj.

Politikat rinore përfshijnë: Një strategji e zbatuar nga autoritetet publike për t’u ofruar të rinjve mundësi dhe përvoja që mbështesin integrimin e tyre të suksesshëm në shoqëri dhe u mundësojnë atyre të jenë anëtarë aktivë dhe të përgjegjshëm të shoqërisë dhe agjentë të ndryshimit (Këshilli i Evropës CM / Rec (2015) 3.

Politikat rinore ofrojnë: Hapësira për mundësitë, pjesëmarrjen, përfshirjen, autonominë, solidaritetin, por edhe mirëqenien, mësimin, kohën e lirë, punësimin etj.

Politikat rinore ofrojnë: Qasjet që variojnë nga rregullimi i emancipimit, nga parandalimi te ndërhyrja, nga proaktive në reaktive, të orientuara nga problemi te mundësitë e fokusuara.

Për të hartuar politika rinore Autoritetet publike duhet ti përfshijnë në proces:

- Këshillat rinorë;
- OJQ-të rinore;
- Grupet e interesit;
- Grupet rinore;
- Punonjësit rinorë;
- Studiuesit rinorë;
- Të rinjtë;
- Shkollat;
- Mësuesit;
- Punëdhënësit;
- Personeli mjekësor;
- Punonjës socialë;
- Grupe besimi;
- Media dhe shumë të tjera.



¹ <https://www.coe.int/en/web/youth/about-youth-policy>

Kush vendos për politikat rinore?

Çdo shtet vendos se çfarë konsiderohet politikë rinore. Politikat rinore janë pasqyra e qeverisë së një vendi se si i shikon të rinjtë e atij vendi.

Këshilli i Evropës promovon politika rinore që bazohen në të **drejtat e njeriut** dhe **standardet demokratike**, të përqendruara te **mundësitë, përfshijnë të rinjtë** në formulimin dhe zbatimin e tyre, krijojnë kushte **për të mësuar, mundësi** dhe **përvojë** dhe bazohen në një mbledhje të fuqishme të dhënave. Ata duhet të vlerësojnë rolin e punës së të rinjve dhe të **mësuarit joformal**, të theksojnë rëndësinë e një qasjeje ndër-sektoriale dhe të theksojnë nevojën **për dialog** me të rinjtë.

POLITIKAT RINORE NË KOSOVË

Kosova ka hartuar legjislacion të veçantë që promovon fuqizimin e të rinjve. Përveç nivelit qendror politika rinore hartojnë edhe komunat. Disa nga ligjet, dhe dokumentet qeveritare kryesore që promovojnë fuqizimin e të rinjve në Kosovë janë: **Ligjet**.



LIGJ PËR FUQIZIM DHE PJESËMARRJE TË RINISË²

Ky ligj ka për qëllim avancimin dhe riafirmimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes, pa kurrfarë dallimi dhe përjashtimi, në zhvillimin e një shoqërie demokratike, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së të rinjve dhe të statusit të tyre shoqëror.

Ky ligj përcakton:

- 1.1. përgjegjësitë themelore për fuqizimin e sektorit rinor në Kosovë dhe përkrahjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje.
- 1.2. përgjegjësitë e institucioneve të qeverisjes qendrore dhe lokale ndaj të rinjve dhe organizatave rinore në fushat përkatëse të rregulluara me këtë ligj.
- 1.3. punën vullnetare dhe edukimin joformal të të rinjve.
- 1.4. udhëzimin për licencimin e qendrave rinore.

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2654>

LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KOMISIONIT EVROPIAN DHE KOSOVËS MBI PJESËMARRJEN E KOSOVËS NË ‘ERASMUS +’, PROGRAMIN E UNIONIT PËR ARSIM, TRAJNIM, RINI DHE SPORT³

Ky ligj është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 20 shtator 2018 ku me anë të këtij ligji, ratifikohet Marrëveshja ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në ‘Erasmus +’, Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport.

LIGJ PËR SPONSORIZIME NË FUSHËN E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT⁴

Ky ligj rregullon përkrahjen dhe mbështetjen financiare e materiale të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive përmes sponsorizimeve dhe reklamave.

STRATEGJIA PËR RININË 2019-2023

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit ka hartuar dokumentin strategjik “**STRATEGJIA PËR RININË 2019-2023**”⁵

Kjo Strategji ka tri objektiva:

1. Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive
2. Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës
3. Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurve për të rinjtë

Strategjinë e plotë mund ta gjeni këtu: https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Strategjia_per_Rini-2019-2023.pdf

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18023>

⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13271>

⁵ https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Strategjia_per_Rini-2019-2023.pdf

FONDACIONI RINOR EUROPIAN (EUROPEAN YOUTH FOUNDATION)⁶

Fondacioni Rinor Evropian ofron mbështetje financiare dhe arsimore për aktivitetet rinore evropiane, ai ka një buxhet vjetor prej rreth 3.7 milion €. Ky fondacion është një mjet i fuqishëm për bashkëpunimin rinor evropian.

Ai mbështet aktivitetet rinore evropiane të organizuara nga organizata dhe rrjete joqeveritare rinore, si takime ndërkombëtare rinore, konferenca, fushata, kurse trajnimi, seminare, vizita studimore, të cilat kanë si rezultate të mundshme ekspozita, botime, materiale audio-vizuale dhe faqe interneti.

KUSH MUND TË APLIKOJ?

- Organizatat Rinore ndërkombëtare;
- Rrjetet e organizatave rinore ndërkombëtare;
- Rrjetet rajonale të organizatave rinore;
- Organizatat nacionale rinore;
- Organizatat lokale rinore.



ÇFARË MBËSHTETËT NË KUADËR TË FONDACIONI RINOR EUROPIAN (EUROPEAN YOUTH FOUNDATION)⁷

- **Prioritetet e Këshillit të Evropës:** Për të marrë mbështetjen e Fondacionit Rinor Evropian, është thelbësore që projekti juaj të jetë brenda vlerave dhe punës së Këshillit të Evropës, si dhe prioriteteve të Sektorit të Rinisë.
- **Aktivitete Ndërkombëtare:** Takime ndërkombëtare në Evropë të cilët kontribuojnë në punën e sektorit të rinjve të Këshillit të Evropës në temë, metodologji dhe me një dimension të qartë evropian.
- **Plane vjetore të punës:** Grup i aktiviteteve të suksesshme për një periudhë njëvjeçare, të ndërlidhura dhe që kontribuojnë në të njëjtin qëllim më të gjerë. Duhet të jetë në përputhje me atë që bëni dhe doni të arrini.
- **Grant strukturor:** Janë dy lloje grantesh strukturore: **grant strukturor për 2 vite radhazi** dhe **grant i njëhershëm**. Këto janë grante për kostot e përgjithshme administrative.
- **Aktivitete pilot:** Një aktivitet pilot duhet të jetë një “ndërhyrje”, d.m.th. një aktivitet që adreson një sfidë kontekstuale shoqërore, e që prek të rinjtë në nivel lokal. Ai gjithashtu duhet të bazohet në risi ose në përsëritje.

⁶ <https://www.coe.int/en/web/european-youth-foundation>

⁷ <https://www.coe.int/en/web/european-youth-foundation/what-we-support>

VENDIMI PËR GRANTE

Komiteti i Programimit për Rininë (Programming Committee on Youth)⁸ është organi i bashkëmenaxhuar i sektorit të rinjve të Këshillit të Evropës që merr vendime për të gjitha aplikimet për grante të paraqitura (aktivitetet ndërkombëtare, planet vjetore të punës, grantet strukturore dhe aktivitetet pilot).

DISA NGA TEMAT QË MBËSHTETEN NGA FONDACIONI RINOR EUROPIAN (EUROPEAN YOUTH FOUNDATION)

Pjesëmarrja / Barazia gjinore / Diversiteti / Romët

Jo Lëvizja për gjuhën e urrejtjes

Emigrantët / Refugjatët /

Ndërtimi i paqes

SITË APLIKOJMË (6 KRITERET)

6 Kriteret që ju ndihmojnë të shikoni nëse keni të drejtë për mbështetje financiare nga Fondacioni Rinor Europian (European Youth Foundation)

1. **Organizata ime është një organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare;**
2. **Organizata ime ka statutin e sajë**
3. **Organizata ime drejton aktivitete për të rinjtë (15-30 vjeç).**
4. **Janë të rinjtë ata që marrin vendime për programin tonë të aktiviteteve.**
5. **Anëtarët e organizatës sime janë të moshës nga 15 deri në 30 vjeç.**
6. **Puna jonë është në përputhje me vlerat dhe prioritetet e Këshillit të Evropës.**

REGJISTRIMI I ORGANIZATËS ONLINE

Para aplikimit organizata duhet të regjistrohet online në sistemin e fondacionit. Për më shumë informata për regjistrim ju mund të vizitoni faqen më poshtë:

<https://rm.coe.int/how-to-register-oct-2018-en-rev/16808ea4e6>

⁸ <https://www.coe.int/en/web/european-youth-foundation/who-decides-and-how>

AFATET PËR APLIKIM

Janë dy afate për aplikim:

I Prill

(mesnatë sipas kohës Evropës Qendrore)

I Tetor

(mesnatë sipas kohës Evropës Qendrore)

Materiale të rëndësishme për organizim të EDUKIMIT JO FORMAL

Disa nga materiale të rëndësishme që organizatat mund ti gjejnë për organizim të aktiviteteve të edukimit jo formal:

COMPASS- Manual për edukim në të drejtat e njeriut për të rinj

<https://www.coe.int/en/web/compass>

GAMES APP- Është një mjet argëtues dhe interaktiv për të gjetur lojëra që mund të përdoren në praktikë nga animatorët dhe punonjësit e të rinjve

<https://www.summerexchangeofanimators.eu/game-apps.html>

ToolBoxWebApp – Obsessu- kutia e veglave, ku mbledhë disa aktivitete të ndryshme pedagogjike që synojnë të mbështesin aktivistët e nxënësve të shkollave dhe organizatat studentore të shkollave në nismat e tyre arsimore.

<https://www.obessu.org/app/>



